



Pranuar / Doretuar Primiemo/Prodato Received/Delivery	30.06.2023	3 vitit god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAMSHICK	9989/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.755/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.755/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme- Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.755/2023 e datës 18.05.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, paragrafi 2 dhe 3 si dhe nenin 7 dhe 9 të dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 05.05.2023 ka njoftuar lidhur me konkursin me numër të referencës RN00011607, ndërsa me datën 26.05.2023 ka shpallur konkursin për pranim me emrin e grupit Specialistë të Arsimit në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Inspektorati i Arsimit të Kosovës lidhur me pozitën e punës "Inspektor i Arsimit" SIA Prizren, për klasën e pozitës Profesional 1.

Më datë 18.05.2023 ankuesi ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4328/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me pretendimin ankimor se Konkursi me numër reference RN00011607 i datës 26.05.2023 është në kundërshtim me Ligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës me numër Nr.06/L-046, Udhëzimin Administrativ të MASHT Nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimin Administrativ MASHT Nr. 05/2015 normativi për mësimdhënës të arsimit profesional, Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil si dhe në kundërshtim me Kodin sipas Listës së katalogut të SHC, si dhe kërkon nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që ta anuloj Konkursin e lartë cekur dhe ta rishpall konkursin e ri duke specifikuar Inspektor Administrativ i Arsimit apo Inspektor Pedagogjik i Arsimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.06.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë në Ministrinë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Ndërsa Këshilli me datë 15.06.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesa me numër të protokollit 4328/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkurs me numër të referencës RN00011607 i datës 26.05.2023; Konkurs me numër të referencës RN00011548 i datës 18.05.2023; Konkurs me numër të referencës RN00010341 i datës 23.11.2023; Konkurs me numër të referencës RN00011575 i datës 23.05.2023; E-mail i datës 16.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e parashtruar nga ankuesi si dhe provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00011607 më datë 26.05.2023 për emrin e grupit Specialistë i Arsimit në Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Inspektorati i Arsimit të Kosovës për pozitën e punës "Inspektor i Arsimit"- SIA Prizren.

Më tej nga shkresat e lëndës Kolegji gjen se ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 18.05.2023 me numër të protokollit 4328/2023, ende pa filluar aplikimi i kandidateve dhe pa përfunduar procesi i verifikimit paraprak nga Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore lidhur me konkursin e lartë cekur.

Andaj në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i 'u referuara dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 të më të cilin parashihet se: *1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të*

parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet..." si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi, ndërlidhur me procesin e rekrutimit për pozitë në fjalë nuk ka aplikuar fare në këtë procedurë dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë të konkurrimit, prandaj bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, ku theksohet se „ Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative.” Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 125 paragrafi 1, i cili përcakton se: “Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”), rrjedhimisht ankuesi ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk e ka parashtruar kundër një akti administrativ apo ndonjë mosveprimi të institucionit, për shkak që nuk ka parashtruar asnjë kërkesë që institucioni ka qenë i obliguar t’i përgjigjet, për me tepër meqenëse ankuesi nuk ka dëshmuar me asnjë provë që ka aplikuar në konkursin për pranim me Nr. Reference RN00011607 i datës 26.05.2023 me emrin e grupit Specialistë të Arsimit në Ministrin e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Inspektorati i Arsimit të Kosovës lidhur me pozitën e punës “Inspektor i Arsimit” SIA Prizren, për klasën e pozitës Profesional 1, atëherë sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, të njëjtit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës apo të njëjti nuk i është mohuar asnjë e drejtë në këtë procedurë, rrjedhimisht pala ankuese nuk ka legjitimitet për parashtrimin e ankesës dhe për pretendimet kundër një procedure që nuk ka qenë pjesë e saj siç parashihet me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...” si dhe ndërlidhur me nenin 14 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të këtij ligji.

Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Si me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje

*Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.
Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.755/2023

Kaltrina Avdullahi-Preņaj


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

